

Zhvillimi i projektit MEMOLA bazohet në analizën e peizazheve kulturore prej antikitetit të vonë e deri në ditët e sotme, duke vlerësuar lidhjen mes shoqërive njerëzore dhe burimeve natyrore.

OBJEKTIVAT TONA

Hulumtimi i procesit të formimit të peizazheve historike në lidhje me përdorimin e burimeve natyrore, në veçanti tokat dhe ujërat.

Projektimi në kontekste të përshtatshme i strategjive të ruajtjes, shpërndarjes dhe vlerësimit të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.

Stimulimi i strategjive të zhvillimit të qëndrueshëm në zonat rurale duke analizuar kontekstet e sistemeve agrare dhe përpjekjet e tyre aktuale për mbijetesë.

Aplikimi i një qasjeje multidisiplinore duke përfshirë një gamë të gjerë specialistësh të përfshirë në fushën e trashëgimisë kulturore, të tillë si historianë, arkeologë, antropologë, agronomë, botanistë dhe hidrogjeologë.

memola project.eu

Projekti MEditerranean MOuntainous Landscapes, i njohur gjithashtu në formën e shkurtuar MEMOLA, përfshin dhjetë partnerë dhe koordinohet nga Universiteti i Granadës, Spanjë. Projekti ka për qëllim analizimin e menaxhimit të ujërave dhe tokave, nëpërmjet një qasjeje ndërsjellë, në katër zona malore të Evropës Mesdhetare:

- Sierra Nevada (Spanjë)
- Monti di Trapani (Itali)
- Lugina e Vjosës Shqipëri
- Colli Euganei (Itali)

 @memolaproject

 /memola.project

 +MEMOLAPROJECT

 /MEMOLAFP7PROJECT



European
Commission

Ky projekt financohet nga Programi FP7 i Bashkimit Evropian për Kërkimin, Zhvillimin Teknologjik dhe Prezantimin, në kuadrin e Marrëveshjes për Ndihmë Financiare n° 613265

MEDITERRANEAN MOUNTAINOUS LANDSCAPES

një qasje historike në trashëgiminë kulturore bazuar në sistemet agrare tradicionale



UNIVERSIDAD DE GRANADA



UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI PADOVA



QENDRA E KËRKIMEVE DHE PROMOVIMIT TË PEIZAZHEVE HISTORIKO-ARKEOLOGJIKE SHQIPTARE



UNIVERSIDAD DE CÓRDOBA



UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI PALERMO



UNIVERSITY OF SHEFFIELD



EACHTRA ARCHAEOLOGICAL PROJECTS LIMITED




ARQUEOANDALUSÍ ARQUEOLOGÍA Y PATRIMONIO



CONSEJO SUPERIOR DE INVESTIGACIONES CIENTÍFICAS



CENTRO UNESCO DE ANDALUCÍA



Data © OpenStreetMap contributors. Licensed under the Open Data Commons Open Database License. Design © Mapbox. Licensed according to the Mapbox Terms of Service.

Colli Euganei, Itali

Colli Euganei janë kodra të formuara si rezultat i lidhjeve mes zhvillimeve të veçanta gjeologjike e gjeomorfologjike dhe traditës së përdorimit të tokave nga banorët e zonës. Në periudhën e vonë romake ndodhën ndryshime të rëndësishme në peizazh, të cilat vazhduan në epokën Bizantine, gjatë procesit të feudalizmit e deri në pushtimin venecian.



Lugina e Vjosës, Shqipëri

Lugina e Sipërme e Vjosës, pjesë e rajonit historik të Epirit, gjendet në Jug-Lindje të Shqipërisë. Ka qenë pjesë e Perandorisë Bizantine deri në pushtimin otoman të shekullit XV. Në kohën e sistemit komunist peizazhi historik i Luginës pësoi ndryshime rrënjësore si rrjedhojë e punimeve agrikulturore.



Monti di Trapani, Itali

Monti di Trapani të gjendura në veri-perëndim të Sicilisë, karakterizohen nga vargmale me orientim të njëjtë me bregdetin, çka ka favorizuar ngjashmëritë në kulturë dhe natyrë mes tyre. Pas rënies së Perandorisë Romake, procesi historik ka vazhduar me periudhën bizantine, pushtimet Normane dhe Arabe, e deri në periudhën e gjatë të dominimit Aragonas.



Sierra Nevada, Spanjë

Parku Kombëtar dhe Natyror i Sierra Nevadës është një zonë e mbrojtur që gjendet në provincat e Granadës dhe Almeirës. Peizazhi ka pësuar ndryshime rrënjësore, gjatë periudhës romake të vonë, prezencës Arabe dhe Maure, e më tej pushtimit Kastilian, si rrjedhojë e shfrytëzimit të burimeve natyrore.

